



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 03/2023 (JR)
Nr. 03/2 regj.

Tiranë, më 19.02.2024

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e enjte, në datën 07.03.2024, ora 10:00**, do të shqyrtohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri (JR) 03/2023, datë 17.01.2023 për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 592, datë 24.11.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Erion Pano.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykues
Relatore e Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtar

Rezarta Schuetz
Mimoza Tasi
Albana Shtylla
Ina Rama
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publik.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES

GJYQTARE

Rezarta Schuetz
REZARTA SCHUETZ

